

Shënim  
deputati

Adresa: Rr. Abdulla Keta, Nr. 1, Tiranë  
Nr. tel.: 0696994162  
E-mail: vikicipi@protonmail.com



Tiranë, më 30.03.2023

### KËRKESE

**Lënda:** Shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit të propozuar nga 20.000 zgjedhës  
“Për përcaktimin e minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kuvendit të Republikës së Shqipërisë  
Rruga “Ismail Qemali”, Tiranë

Në mbështetje të nenit 81 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënese të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.196 datë 29/09/2022 dhe nr.5 datë 09/01/2023, si dhe Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Komiteti Përfaqësues i nismës ligjvënese të zgjedhësve “Për përcaktimin e minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë” kërkon shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit.

Bashkëngjitur kësaj kërkesë gjendet:

- Projektligji i plotë, së bashku me relacionin që përshkruan dhe analizon qëllimin që kërkon të arrijë dhe që për ligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij.
- Vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve si dhe regjistrimin e nismës ligjvënese të zgjedhësve.
- Dokumentet identifikues të anëtarëve të Komitetit Përfaqësues të nismës ligjvënese të zgjedhësve.

Duke shpresuar në një bashkëpunim të frytshëm, në çdo rast mbetemi në dispozicion për sqarime të mëtejshme dhe në pritje të vendimmarrjes pozitive nga ana juaj.

Me konsideratë,

Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënese të zgjedhësve “Për përcaktimin e minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë”

Znj. Anxhela Nasto – zgjedhëse

Z. Arlind Qori – zgjedhës

Z. Jani Marka – zgjedhës

Znj. Geraldina Mançka – zgjedhëse

Anxhela Nasto  
Arlind Qori  
Jani Marka  
Geraldina Mançka

Znj. Mirela Ruko – zgjedhëse *Mirela Ruko*

Z. Redi Muçi – zgjedhës *Redi Muçi*

Znj. Vitori Çipi – zgjedhëse *Vitori Çipi*

Z. Xhuliano Bregasi – zgjedhës *Xhuliano Bregasi*



PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.

“PËR PËRCAKTIMIN E MINIMUMIT JETIK”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë  
zgjedhësve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Qëllimi**

Ky ligj synon të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët, familjet në nevojë dhe kategoritë e tjera përfituese të skemave të asistencës sociale, duke përcaktuar nivelin e minimumit të nevojshëm financiar për të siguruar kushtet bazë të jetesës, zhvillimin e aftësive e mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

## Neni 2

### **Përkufizime**

1. “Minimumi jetik” është e drejta për të përfituar shumën monetare që garanton kushtet bazë të jetesës për individët ose familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.

## Neni 3

### **Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuar që janë përfitues të programeve të asistencës sociale sipas ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe për përfituesit e pensionit social në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit Nr. 7703, Datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Këshilli i Ministrave përcakton kategori të tjera dhe kriteret për përfitimin e minimumit jetik, përveç kategorive të parashikuara në paragrafin 1.

## Neni 4

### **Detyrimi për respektimin e minimumit jetik**

Shuma monetare për përfituesit nga programet e asistencës sociale dhe përfituesit e pensionit social, sipas fushës së zbatimit të këtij ligji, nuk mund të jetë më e vogël se vlera e minimumit jetik e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

## Neni 5

### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të përcaktojë vlerën e minimumit jetik sipas propozimit, në bazë të një studimi objektiv dhe gjithëpërfshirës të Institutit të Statistikave (INSTAT).

2. Në përcaktimin e kësaj vlere, sipas paragrafit 1, mbahen parasysh nevojat e individit për produktet ushqimore dhe jo ushqimore të përshtatshme, të tilla si, ushqim të përshtatshëm, ujë, veshmbathje, strehim, edukim dhe nevoja minimale social- kulturore.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për indeksimin e përvitshëm të vlerës së minimumit jetik, si dhe për rillogaritjen e tij çdo 5 vjet.

4. Brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, Këshilli i Ministrave përcakton kriteret që duhet të përmbushin individët në nevojë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 3, paragrafi 2 të ligjit, me qëllim që të përfitojnë shumën e minimumit jetik.

#### Neni 6

##### **Shfuqizime**

Paragrafi i dytë i nenit 5/1 të ligjit Nr. 7703, Datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave që përcakton vlerën e minimumit jetik, sipas këtij ligji.

#### Neni 7

##### **Hyrja në fuqi**

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Efektet financiare të ligjit fillojnë në mënyrë të përshkallëzuar sipas tabelës bashkëngjitur në shtocën 1 të ligjit.

KRYETARI

Miratuar në datën \_\_/\_\_/\_\_\_\_\_.

## Shtojca 1

<b>Periudha</b>	<b>Masa e pensionit social</b>
2024-2025	65% e vlerës së minimumit jetik të indeksuar me rritjen e inflacionit.
2026-2031	85% e vlerës së minimumit jetik të indeksuar me rritjen e inflacionit.
2032 e vijim	100% e vlerës së minimumit jetik të indeksuar me rritjen e inflacionit.

## **RELACION SHOQËRUES PËR PROJEKTLIGJIN “PËR PËRCAKTIMIN E MINIMUMIT JETIK”**

### **I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë minimumin jetik dhe respektimin e këtij minimumi në programet publike të asistencës sociale, përfituesit e pensionit social si dhe çdo kategori tjetër të individëve që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Qëllimi i projektligjit nuk është të prezantojë skema të reja të përfitimit nga transfertat sociale, por të përcaktojë që pagesat aktuale të respektojnë një vlerë minimale e cila mbulon nevojat bazë të jetesës së sigurtë për produkte ushqimore dhe jo ushqimore.

Përmes përcaktimit të minimumit jetik, ligji ka si objektiv zbutjen e varfërisë dhe nxitjen e përfshirjes shoqërore të shtresave në nevojë duke përcaktuar për herë të parë që përfitimet nga skemat e ndihmës ekonomike dhe pensionit social të mos bien në një minimum të nevojshëm për të përballuar nevojat bazë të jetesës.

### **II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është në programin politik të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu projektligji nuk është pjesë e programit analitik të projekt-akteve pasi është inicuar nga ana një grupim qytetarësh.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet vendosmëria për të ndërtuar një shtet social për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, “...me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor”.

Përpos këtij parashikimi në preambul, në nenin 52 të saj parashikohet e drejta e personave që mbeten të papunë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tyre dhe kur nuk kanë mjete jetese, të marrin ndihmë sipas kushteve të parashikuara me ligj. Pra, Kushtetuta njeh të drejtën e individëve në kushte të caktuara që të ndihmohen nga shteti. Por, kjo dispozitë duhet lexuar sipas frymës së preambulës që ndihma (ekonomike) e ofruar nga ana e shtetit duhet të synojë mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe kjo arrihet kur së paku përmes ndihmës plotësohen nevojat bazë të jetesës. Në këtë kontekst, skemat e asistencës sociale të parashikuara sipas ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe për përfituesit e pensionit social në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit Nr. 7703, Datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të synojnë pikërisht plotësimin e kushteve bazë të jetesës.

Për më tepër, ndër objektivat socialë të parashikuara në Kushtetutën tonë është përkujdesja dhe ndihma për të moshuarit, jetimët dhe invalidët. Këto janë kategori të veçanta të cilat për shkak të vulnerabilitetit, kërkojnë vëmendje më të madhe shtetërore. Prandaj, kategori të tilla janë përfshirë në programet e asistencës sociale. Një nismë pozitive në drejtim të përkujdesjes ndaj të moshuarve që nuk përfitojnë nga skema e kontributeve shoqërore ka qenë dhe njohja e së drejtës për përfitimin e pensionit social. Megjithatë, vlera monetare e përfituar sipas këtij parashikimi është e pamjaftueshme për të siguruar nevojat bazë të kësaj shtrese.

Ndaj, në përmbushje të këtyre detyrimeve kushtetuese është e rëndësishme që paketa e transfertave sociale nga shteti te personat në nevojë (brenda dhe jashtë skemës së kontributeve shoqërore) duhet të sigurojë plotësimin e kushteve bazë të jetesës. Ky qëllim arrihet, ndër të tjera, duke parashikuar pagesa të paktën në nivelin që përballon kërkesat minimale për të jetuar. Thënë ndryshe, pagesa që garantojnë minimumin jetik. Aktualisht, mungon një parashikim ligjor që të përcaktojë apo të bëjë të përcaktueshëm minimumin jetik. Rregullimi me ligj i minimumit jetik i bën programet e asistencës sociale dhe pensionin social njëherësh, instrumente efektive në funksion të garantimit të kushteve bazë të jetesës.

Ndërhyrja ligjore për përcaktimin e minimumit jetik vjen në të njëjtën linjë me Shtyllën Europiane të Drejtave Sociale, e cila përcakton se kushdo që ka burime të pamjaftueshme gëzon të drejtën për të përfituar të ardhura në nivel të përshtatshëm që sigurojnë jetesë me dinjitet në të gjitha fazat e jetës dhe akses efektiv në mallra dhe shërbime. Për pjesën ekonomikisht aktive, përfitimet e të ardhurave minimale duhet të kombinohen me nxitjet për (ri)integrim në tregun e punës<sup>1</sup>.

Aktualisht, ka një kuadër të plotësuar ligjor lidhur me ndihmën ekonomike si dhe pagesat e tjera që persona që i përkasin kategorive të veçanta marrin prej shtetit. Ky përbën një hap pozitiv, por duhet që këto transferta të sigurojnë nevojat minimale për artikujt ushqimorë dhe jo ushqimorë.

Në të vërtetë ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale” synon zbutjen e varfërisë dhe nxitjen e integritit shoqëror. Megjithatë, një nga problemet me këtë ligj, lind për shkak se transfertat sociale nga shteti drejt familjeve në nevojë (apo kategorive të veçanta, sipas përcaktimit të ligjit) nuk arrijnë të sigurojnë kushtet minimale për të jetuar. Sipas Raportit të UNDP dhe Avokatit të Popullit për Minimumin Jetik, masa e NE-së (Ndihmës Ekonomike) nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për ushqim, por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor për individët dhe familjet kur ata kanë nevojë. Shifrat tregojnë që rreziku i varfërisë është shumë i lartë, 49% e popullsisë janë në rrezik varfërie ose jetojnë me të ardhura shumë të ulëta.<sup>2</sup> Ndaj, është e domosdoshme që të përllogaritet minimumi i nevojshëm për jetesë dhe kjo vlerë të shërbejë si standard minimal për frymë për përfituesit nga programet e asistencës sociale dhe përfituesit e pensionit social. Sipas konstatimit nga raporti i sipërpërmendur, skema e ndihmës ekonomike,

<sup>1</sup> Parimi 14, [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/social-summit-european-pillar-social-rights-booklet\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/social-summit-european-pillar-social-rights-booklet_en.pdf)

<sup>2</sup> Raport për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri 2021, UNDP Albania, f. 4.



ndonëse ndër më të ulëtat në Europë, po e arrin gradualisht qëllimin e saj për zbutjen e varfërisë, por duhet përmirësuar.<sup>3</sup>

**Pavarësisht plotësimit të kuadrit rregullues me ligje që përcaktojnë llojet dhe mënyrat e ndihmës dhe përkrahjes shtetërore ndaj shtresave në nevojë, nuk ka asnjë përcaktim ligjor lidhur me vlerën e pagesave që përfitojnë subjektet e kualifikuar për të përfituar nga këto skema dhe kushtëzimin që këto pagesa të mos bien nën minimumin e nevojshëm për plotësimin e nevojave bazike. Për këtë arsye, ky projektligj synon pikërisht përcaktimin e vlerës minimale që pagesat, e kryera nga shteti drejt përfituesve të skemës jo-kontributive dhe kontributive, të mos bien nën këtë vlerë.**

Sigurisht, **kategoria e parë** e subjekteve që duhet të përfitojnë pagesa të tilla janë **individët që kualifikohen për të përfituar ndihmën ekonomike, sipas kritereve të përcaktuara nga ligji. Rrjedhimisht, sipas projektligjit përcaktohet që pagesat e ndihmës ekonomike dhe pagesat për aftësinë e kufizuar, nuk mund të jenë më të ulëta se minimumi jetik i miratuar nga Këshilli i Ministrave. Për shkak të dinamikës që ka kjo vlerë, dhe ndryshimit të vazhdueshëm për t'iu përshtatur ndryshimit të çmimeve, projektligji nuk përfshin vlerën konkrete në dispozitat e tij, por përcakton që ajo duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe të indeksohet në mënyrë periodike.**

**Nga ana tjetër, nuk mund të krijohet pabarazi në trajtim dhe rrjedhimisht, reforma e përcaktimit të minimumit jetik duhet të shtrihet domosdoshmërisht edhe në skemën e pensioneve që njihen dhe jepen nga shteti si ndaj shtetasve që kanë paguar kontributet shoqërore, ashtu edhe ndaj asaj kategorie që ndonëse nuk hyn në grupin e kontribuuesve, përfiton të ashtuquajturin pension social. Për këtë arsye, është e nevojshme që edhe vlera e pensionit social të ndryshohet duke u barazuar me minimumin jetik. Kjo realizohet përmes ndryshimit të heshtur që ky ligj i bën ligjit Nr. 7703, Datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.**

Duke qenë se ky pension shërben si bazë për përllogaritjen e llojeve të tjera të pensioneve, atëherë ky ndryshim do të sjellë pashmangshmërisht ndikim financiar edhe në skemën e pensioneve të tjera të njohura sipas ligjit Nr. 7703, Datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ndryshimi i masës së pensionit social është i domosdoshëm, pasi me këtë vlerë lidhet edhe ndihma ekonomike, e cila maksimalisht sipas nenit 12 (8) të ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale”, nuk mund të tejkalojë 150% të pensionit social.**

Një nga problematikat me të cilat mund të përballet miratimi i këtij projektligji, lidhet me kufizimet buxhetore dhe pamundësinë për të rritur menjëherë vlerën e pensionit social e rrjedhimisht edhe të

---

<sup>3</sup> Raport për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri 2021, UNDP Albania, f. 4

ndihmës ekonomike. Për këtë arsye, për të patur një efekt financiar të shtrirë në kohë, ligji parashikon një zbatim të përshkallëzuar të tij.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është plotësisht në përputhje me Kushtetutën madje përmbush më së miri parashikimin kushtetues për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, si dhe garantimin e së drejtës për ndihmë ekonomike për personat që nuk kanë mjete jetese. Përmes këtij ligji mundësohet që ndihma ekonomike dhe pensioni social të jetë në masë të tillë që të garantojë nevojat minimale të jetesës.

Nga ana tjetër, ky projektligj plotëson dhe saktëson rrjetin e ligjeve që rregullojnë pagesat sipas skemës kontributive dhe asaj jo kontributive. Ndaj, ky projektligj përmirëson dhe plotëson një mangësi ekzistuese të kuadrit ligjor në fuqi.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS-NË E BASHKIMIT EUROPIAN**

Ky projektligj nuk për afrofron legjislacionin tonë me *acquis*. Ndonëse shtetet anëtare të Bashkimit Europian e kanë të përcaktuar minimumin jetik, nuk ka momentalisht një akt në nivel Europian që të diktojë përcaktimin e kësaj vlere. Secili shtet sipas nivelit të zhvillimit ekonomik dhe metodologjisë së përzgjedhur ka të përcaktuar një vlerë minimale që akordohet si ndihmë monetare drejt kategorive përfituese.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT**

Ligji ka një strukturë shumë të thjeshtë. Ai përmban vetëm 7 dispozita, pasi qëllimi i tij nuk është prezantimi i skemave të reja apo i kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike apo pagesave të tjera, por të integrojë në skemat ekzistuese standardin e respektimit të minimumit jetik. Qëllimi i tij është të përcaktojë që transfertat sociale të përfituara sipas regjimeve të ndryshme ligjore, duhet të respektojnë një standard minimal që garanton një jetë me dinjitet duke plotësuar nevojat minimale për produkte ushqimore dhe jo-ushqimore. Ndaj, ligji është hartuar në mënyrë koncize duke prezantuar konceptin e minimumit jetik i cili duhet të përbëjë vlerën minimale që përfitojnë kategoritë në nevojë. Ligji përcakton edhe kategoritë përfituese të minimumit jetik, të cilat janë individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuar që janë përfitues të programeve të asistencës sociale sipas ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe për përfituesit e pensionit social në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit Nr. 7703, Datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Përveç këtyre kategorive, ligji i ngarkon Këshillit të Ministrave të identifikojë, sipas kriterëve të miratuara, kategori të tjera në nevojë që përfitojnë një pagesë të tillë.

Në funksion të arritjes së qëllimi, ligji i ngarkon një rol më rëndësi në këtë proces Këshillit të Ministrave i cili duhet të përcaktojë vlerën e minimumit jetik, brenda kuadrit të metodologjive që

përdoren për përcaktimin e këtij minimumi. Në këtë përlllogaritje institucioni përgjegjës, INSTAT, duhet të marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së studimit të tij shportën e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, për të plotësuar nevoja si ushqimi i përshtatshëm, ujë, veshmbathje, strehim dhe nevoja minimale social-kulturore. Këto të fundit mundësojnë përfshirje sociale për të jetuar një jetë me dinjitet. Për shkak të natyrës dinamike që ka kjo vlerë, ligji ka ngarkuar Këshillin e Ministrave për ta indeksuar në mënyrë të përvitshme, si dhe të rillogaritet në një periodicitet 5 vjeçar për të reflektuar ndryshimet e tregut.

Në përfundim, ligji përcakton një skemë për zbatimin e përshkallëzuar të kësaj nisme dhe fillimin e efekteve financiare, duke dhënë një dritare të mjaftueshme për të reflektuar ndikimet që përcaktimi i këtij minimumi do të ketë në buxhet. Skema i referohet vlerës së pensionit social, pasi sipas rregullimit në fuqi, kjo vlerë shërben si baza për përlllogaritjen e ndihmës ekonomike si dhe pensioneve që përfitohen nga skema kontributive.

Dispozita e fundit përcakton datën e hyrjes në fuqi të ligjit, që është 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.**

Së pari, një organ me rëndësi në zbatimin dhe jetësimin e këtij ligji është Këshilli i Ministrave i cili sipas projektligjit ka për detyrë përcaktimin e masës së minimumit jetik sipas metodologjisë së zbatuar nga INSTAT, e cila duhet të vlerësojë produktet e nevojshme ushqimore dhe jo ushqimore për realizimin e një jete me dinjitet. Përpos Këshillit të Ministrave një rol me rëndësi do të luajë Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e cila përmes institucioneve në varësi të saj, Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, do të duhet të koordinojë punën për të reflektuar dhe për të zbatuar detyrimet konkrete ligjore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT.**

Ky projektligj është hartuar me asistencën juridike e tekniko-legjislative të ekipit të ekspertëve të fushës të kontraktuar nga ana e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

## **IX. EFEKTET FINANCIARE TË PROJEKTLIGJIT**

Duke qënë se për përcaktimin e minimumit jetik kërkohen informacione në lidhje me: produktet më të domosdoshme për një ushqyerje të shëndetshme (e cila është e ndryshme për rajone të ndryshme); produktet më të domosdoshme jo-ushqimore, (siç janë strehimi veshmbathja, etj.); shërbimet minimale social-kulturore, llogaritja e tij paraqitet shumë komplekse, dhe për rrjedhojë edhe llogaritja e ndikimit financiar të këtij projektligji paraqet vështirësi. Megjithatë, për qëllime të llogaritjeve të përafërta në ndihmë mund të na vijë propozimi për minimumin jetik i bërë nga Avokati i Popullit, i cili në raportin e tij të fundit (i referohemi atij të vitit 2021), arrin në

përfundimin se minimumi jetik mesatar për një individ sipas të dhënave të vitit 2019 ishte rreth 17, 875 Lekë në muaj.

Sipas Raportit të Avokatit të Popullit të vitit 2021, minimumi jetik duhet të “përfshijë kostot bazë për shpenzimet minimale jetike mujore: ushqimore (ushqimet, pijet jo-alkoolike, mallra e shërbime të këtij konteksti, të cilat përbëjnë rreth 45% të këtyre shpenzimeve) dhe ato jo-ushqimore (shpenzimet për banesën, ujin, energjinë elektrike, qiranë, mobilimin, mirëmbajtja e zakonshme e banesës, veshmbathja, shëndeti, transporti, komunikimi, arsimimi e shërbime e shpenzime të këtij konteksti, që përbëjnë rreth 55 % të këtyre shpenzimeve)”.

Midis metodave më të zakonshme që janë metoda analitike dhe relative, nisur nga disponueshmeria e informacionit, por edhe nga praktika që ndjekin vendet në zhvillim, përlllogaritjet në vendin tonë mund të bëhen bazuar në metodën analitike, e cila nisur nga shporta e mallrave të minimumit jetik dhe çmimet mesatare të këtyre artikujve. Për vlerësimin e kufirit të varfërisë ushqimore mund të merren në konsideratë kërkesat minimale ushqimore për një individ, të rekomanduara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin (FAO), dhe çmimet e produkteve të konsumit sipas Institutit të Statistikave. Megjithatë, përlllogaritjet në praktikë janë më të komplikuar, kjo pasi nuk ka studime të mirëfillta shkencore për listën me artikujt bazë apo zëvendësues ushqimorë dhe jo-ushqimorë, që kontribuojnë në përcaktimin e minimumit jetik dhe nga ana tjetër mjetet financiare minimale që iu duhen individëve janë të ndryshme në rajone të ndryshme të vendit, për shkak se jo vetëm që çmimet e produkteve ndryshojnë, por edhe kërkesat e individëve kushtëzohen, për shembull nga faktorët ekonomike, të zhvillimit, klimaterikë dhe ato kulturore.

Sidoqoftë, angazhimi i institucioneve të tilla si Ministria e Financës dhe Ekonomisë, INSTAT, por edhe Ministria përgjegjëse për Mbrojtjen Sociale dhe Kujdesin Shëndetësor, dhe Agjenci të tjera qendrore e lokale, mund të kontribuojnë në ndërtimin e disa instrumenteve bazike, pse jo edhe në përcaktimin e një formule llogaritje të minimumit jetik për një familje me një numër mesatar anëtarësh (dy të rritur dhe dy fëmijë), të konsideruar në kushtet e mungesës totale në aksesin në resurset përkatëse.

***Përcaktimi i minimumit jetik, është hapi i parë, i cili duhet të pasohet me vlerësimin e burimeve të mundshme për të mbuluar nevojat e individëve/familjeve poshtë minimumit jetik.***

Pavarësisht se mjetet e nevojshme financiare nuk mund të sigurohen menjëherë, përcaktimi i një metodologjie të qartë dhe llogaritja e këtij treguesi të paktën një herë në dy ose tre vjet, do të mund të angazhonte autoritetet që të planifikojnë mënyrën e krijimit dhe përdorimit të burimeve shtesë për periudha afatmesme dhe afatgjata. Një hap tjetër i supozuar mund të ishte klasifikimi i familjeve në nevojë, duke nisur nga grupet në kushte të varfërisë absolute, ku individët madhorë nuk kanë mundësi aksesin në tregun e punës, për të vijuar me kategori të tjera të familjeve më afër kufirit të varfërisë absolute me mundësi që kryefamiljari të bëjë përpjekje për të patur akses në tregun e punës dhe më pas në grupe të tjera sipas nivelit të të ardhurave të familjeve. Ky klasifikim

mund të shërbejë për një presion pozitiv mbi përfituesit për t'u ri-integruar në tregun e punës dhe për ta gjetur vetë aksesin në burimet ekonomike pa pritur mbështetjen nga buxheti i shtetit. Me pak fjalë, në opinionin tonë, kjo do të kërkonte ndërtimin e instrumenteve që nga njëra anë rritin efektivitetin e përdorimit të burimeve dhe nga ana tjetër gradualizojnë mbështetjen për të arritur një nivel të kënaqshëm dhe të arsyeshëm.

## **X. TË DHËNA DHE INFORMACIONE QË NEVOJITEN PËR TË VLERËSUAR KOSTOT APO FATURËN FINANCIARE TË MBËSHTETJES DERI NË MINIMUMIN JETIK**

Për një analizë sa më afër realitetit, nga ana e institucioneve përgjegjëse duhet të sigurohen të dhëna dhe informacione, siç mund të ishin:

- a) Numri i familjeve që janë nën kufirin e varfërisë absolute, sipas këndvështrimit aktual për varfërinë. Të dhënat mund të merren nga INSTAT, ose mund të ketë një vlerësim të përafërt nga Institucionet ndërkombëtare, siç mund të jetë Banka Botërore, etj;
- b) Numri i familjeve që aktualisht gjenden në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike;
- c) Numri mesatar i anëtarëve të familjeve në ndihmë ekonomike dhe përbërja sipas moshës mesatare të pjesëtarëve të familjes. Këto të dhëna mund të jenë të publikuara nga INSTAT, ose mund të ketë edhe vlerësime të përafërta nga organizma të tjera vendase, studime të OJF-ve apo institucioneve ndërkombëtare;
- d) Të dhënat nga regjistrimi më i fundit i popullsisë, ku natyrisht mund të merren të dhëna për individët, statusin e punësimit të tyre, etj. Ky numër duhet mbahet parasysh, për faktin që gjatë tre-katër viteve të fundit vërehen largime të shumta nga vendi, kryesisht nga moshat aktive për punë;
- e) Të dhëna nga sistemi i regjistrimit TIMS mbi numrin e shtetasve që janë larguar nga vendi, të cilët nuk rezultojnë të kenë hyrë në vend për një periudhë më shumë se tre ose gjashtë muaj;
- f) Brenda numrit të familjeve në ndihmë ekonomike, mund të merren informacione për individët në moshën 30-60 vjeç, të cilët potencialisht kanë mundësi ri-integrimi dhe aksesin në tregun e punës;
- g) Numri i individëve që përfitojnë pension social duke përfshirë të dhëna për familjen ku jetojnë, në funksion të nevojës ose jo të mbështetjes me burime financiare;
- h) Numri i personave që marrin pagën minimale përfshirë numrin mesatar të personave në ngarkim, sa nga ky numër bëjnë pjesë në familje ku punon vetëm një individ në moshë madhore;
- i) Numri i individëve me pension nën nivelin e minimumit jetik të përlllogaritur sipas këtij projektligji;
- j) Numri i personave me paaftësi të kufizuar dhe të plotë dhe pensioni që ata marrin, përfshirë të dhënat mbi numrin mesatar të pjesëtarëve të familjeve ku ata jetojnë;

- k) Të dhëna të tjera në varësi të formës që do të propozohet për zgjidhjen ligjore të adresimit të mënyrës së llogaritjes dhe implementimit të skemës së mbështetjes financiare.

## **XI. MBËSHTETJA FINANCIARE**

### **I.1. Nevoja për një standard jetese të përshtatshëm**

E drejta që çdo individ të ketë një standard të përshtatshëm të jetesës konsiderohet e drejtë universale dhe si e tillë ajo është sanksionuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në nenin 25 (1), ku theksohet se “çdokush ka të drejtën për një standard jetese të përshtatshëm për mirëqenien e tij dhe të familjes së tij”. Standardi i jetesës i përshtatshëm, përfshin të drejtën e çdo individit për ushqim, veshmbathje, strehim, kujdes mjekësor dhe për shërbime sociale. Përgjegjësia e shoqërisë është të ndërmarrë masat e duhura për ta garantuar këtë të drejtë themelore. Organet/pushtetet legjislative dhe ekzekutive kanë detyrimin për adresimin dhe krijimin e kushteve për zbatimin e kësaj të drejte.

Vitet e fundit, nga disa institucione janë bërë përpjekje që kjo çështje të fillojë të adresohet. Ministria e Financës dhe Ekonomisë, INSTAT, Avokati i Popullit, Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale, apo edhe aktorë e faktorë të tjerë, janë duke kontribuar në adresimin e kësaj çështje, përmes një sërë instrumentesh, siç janë paga minimale, pensioni social, asistenca sociale, pagesa e papunësisë, etj. Megjithatë, ende nuk është arritur në përcaktimin e një metode apo metodologjie të qartë për ta takon në radhë të parë për llogaritjes, apo thënë ndryshe, njohjes dhe pranimit të kësaj të drejte themelore dhe të detyrimit ndaj anëtarëve të shoqërisë që jetojnë nën kufirin e varfërisë. Liria për jetën, duke qenë një e drejtë themelore, përmban edhe të drejtën apo lirinë e individit për ta mbrojtur këtë të drejtë. Mekanizmat që përdoren për të garantuar mbrojtjen e të drejtës për një standard jetese të përshtatshëm, përfshijnë përcaktimin e kufirit të minimumit jetik dhe adresimin e tij përmes alokimit të burimeve materiale apo financiare për shtresat në nevojë.

Sipas përkufizimit të ILOs “minimumi jetik është një shumë monetare që mundëson blerjen e një sërë produktesh ushqimore të përshtatshme për të siguruar funksionimin normal të trupit të njeriut dhe ruajtjen e shëndetit të tij si edhe një numër minimal artikujsh jo-ushqimorë dhe shërbimesh të nevojshme për të përmbushur nevojat bazë social-kulturore”. Sigurimi i mjeteve financiare për të patur një standard të minimumit jetik, përveçse përmbush një të drejtë themelore, garanton paqen sociale pa të cilën asnjë shoqëri nuk mund të ekzistojë dhe nuk mund të ketë prosperitetin e dëshiruar.

E drejta për një standard të përshtatshëm jetese është adresuar si çështje nga disa agjenci të specializuara të OKB-së, ku mund të përmenden: Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO<sup>4</sup>), Organizata e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin (FAO)<sup>5</sup>, Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO)<sup>6</sup>, etj. Në kuadrin e këtyre organizatave, janë miratuar disa instrumente që synojnë mbrojtjen e një standardi të përshtatshëm jetese.

Komiteti i OKB-së për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (CESCR)<sup>7</sup>, ka bërë një analizë të detajuar në lidhje me të drejtën e njeriut për standard të përshtatshëm jetese. Disa nga këto komente<sup>8</sup>, respektivisht: Komenti i përgjithshëm Nr. 4, *E drejta për të patur strehim të përshtatshëm*, Nr. 12, *E drejta për ushqim të mjaftueshëm* dhe Nr. 15, *E drejta për ujë*, janë analizuar shkurtimisht në këtë material argumentues, për faktin që ato mund të ndihmojnë në përcaktimin e një metode sa më të përshtatshme të përlllogaritjes dhe zbatimit të minimumit jetik. Shqyrtimi dhe analiza e tyre është e dobishme dhe mund të shërbejë si një bazë e përshtatshme për të përcaktuar metodologjinë e përlllogaritjes së elementëve përbërës të veçantë të minimumit jetik në vendin tonë.

E drejta për të patur një standard të përshtatshëm jetese përfshin të drejtën për ushqimin e duhur. Kjo e drejtë përbushet kur individit dhe familjarët e tij kanë mundësi të ushqehen, ose kur ata disponojnë mjetet e duhura financiare për të siguruar një ushqyerje të përshtatshme. E drejta për ushqim duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme. Shoqëria përmes agjencive shtetërore ka obligimin të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të zbutur dhe lehtësuar urinë, si në kohë normale ashtu edhe në kohë fatkeqësish natyrore apo fatkeqësish të tjera. E drejta për ushqim dhe dinjiteti i individit janë të pandashme nga njëra-tjetra. Pa ushqimin nuk mund të garantohet respektimi i të drejtave të tjera.

Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 12, të CESCR, *E drejta për ushqim të mjaftueshëm*, nënvizohet fakti që individët duhet të kenë një sasi dhe cilësi produktesh të mjaftueshme për të kënaqur nevojat e tyre të ushqyerit. Një dietë ushqimore e përshtatshme, përmban një përzierje të lëndëve ushqyese, të cilat ndihmojnë rritjen fizike dhe mendore, zhvillimin e mëtejshëm dhe aktivitetin fizik, në përputhje me nevojat fiziologjike të njeriut, në të gjitha fazat e ciklit të tij të jetës. Nga njëra anë dieta ushqimore duhet të jetë e përshtatshme dhe e diversifikuar për të takon modelit të ushqyerit dhe, nga ana tjetër, në të gjithë ciklin e jetës, individët duhet të kenë aksesin e nevojshëm, për t'u furnizuar me ushqimin e duhur.

---

<sup>4</sup> ILO - the only tripartite U.N. agency that brings together governments, employers and workers of [187 member States](#), to set labour standards, develop policies and devise programs promoting decent work for all women and men

<sup>5</sup> FAO - The Food and Agriculture Organization (FAO) is a specialized agency of the United Nations that leads international efforts to defeat hunger.

<sup>6</sup> WHO - the United Nations agency that connects nations, partners and people to promote health, keep the world safe and serve the vulnerable – so everyone, everywhere can attain the highest level of health.

<sup>7</sup> CESCR - The Committee on Economic, Social and Cultural Rights - the body of 18 independent experts that monitors implementation of the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights by its State parties.

<sup>8</sup> [Treaty bodies Search \(ohchr.org\)](#)

Ushqimi duhet të jetë i sigurtë, i mbrojtur dhe të mos përmbajë substanca të cilat mund të dëmtojnë shëndetin. Kjo i detyron autoritetet shtetërore të vendosin rregulla dhe të monitorojnë procesin e prodhimit të produkteve ushqimore, për të parandaluar rreziqet e dëmtimit nga helmimet apo nga forma të tjera. Siguria lidhet me kujdesin e duhur, luftën kundër falsifikimit dhe higjienën në të gjithë zinxhirin e prodhimit, shpërndarjes dhe të ruajtjes së produkteve ushqimore.

Ushqimi do të konsiderohet i përshtatshëm, nëse produktet janë të pranueshme sipas një kulture të caktuar, që është mbizotëruese në juridiksionin ku jeton individi. Produktet ushqimore duhet të përmbajnë vlerat ushqyese të kërkuara dhe konsumatorët duhet të kenë informacionet e nevojshme.

E drejta e të ushqyerit, nuk mund të plotësohet pa ekzistencën ose disponibilitetin e produkteve ushqimore që garantojnë mirë ushqyerjen. Kjo nënkupton ekzistencën e mundësisë së prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së produkteve që i duhen individit ose familjes së tij, për të garantuar ushqyerjen.

Aksesi në ushqim është një aspekt tjetër i rëndësishëm që përfshin aksesin ekonomik (financiar) dhe aksesin fizik. Aksesi ekonomik, lidhet drejtpërdrejt me nevojën e përcaktimit të një minimumi jetik, pasi nënkupton që individi ose familja e tij, do të kenë burimet e duhura për të mbuluar kostot financiare personale ose familjare për blerjen e ushqimit sipas një diete ushqimore të përshtatshme. Nga ana tjetër, aksesin fizik nënkupton që ushqimi i duhur duhet të jetë i arritshëm për të gjithë popullatën, duke përfshirë individët që nuk janë të aftë për punë, fëmijët e vegjël, të moshuarit, të paaftët fizikisht, të sëmurët, etj.

Jo më pak të rëndësishme janë edhe komentet e tjera të CESCSe për të drejtën për strehim e veshmbathje dhe të drejtën për ujë.

E drejta për strehim nënkupton që çdo individ ka një vend ku të jetojë në siguri, paqe dhe me dinjitet. Sipas komenteve të përgjithshme nr. 4 dhe 7 të CESCSe, e drejta për strehimin e duhur përfshin sigurinë e strehimit, d.m.th. garancinë që individët të jenë të mbrojtur nga dëbimi arbitrar apo kërcënime të tjera. Kostot e strehimit duhet të jenë të përballueshme, d.m.th., shuma që një person ose familje duhet të paguajë për strehimin të mos të jetë aq e lartë sa të kërcënojë ose të kompromentojë arritjen dhe plotësimin e nevojave të tjera bazë. Sigurimi i strehimit është sot një problem i mprehtë në të gjithë botën, pasi çmimet aktuale të apartamenteve të banimit nuk mund të përballohen nga grupet vulnerabël, apo të varfrit, si në vendet e pasura ashtu edhe në vendet në zhvillim. Kur banesat me qira janë të papërballueshme, siguria e qëndrimit të qiramarrësve kërcënohet, pasi ata mund të dëbohen ligjërisht për mos pagesë të qirasë.

Individët duhet të kenë sipërfaqen e duhur të banimit, e cila duhet të sigurojë jetesën dhe mbrojtjen ndaj të ftohtit, lagështirës, nxehtësisë, shiut, erës ose kërcënimeve të tjera ndaj shëndetit. Çdo individ, duke përfshirë grupet e pa favorizuara siç janë të moshuarit, të paaftët fizikisht dhe



mendërisht, individët e sëmurë, viktimat e fatkeqësive natyrore, fëmijët dhe grupet e tjera, duhet të ketë akses në strehim.

Për të qenë i përshtatshëm, strehimi, duhet gjithashtu, të jetë në vendndodhjen e duhur, me qëllim që individi të mund të ketë akses të lehtë në punësim, shërbime të kujdesit shëndetësor, shkolla, qendra të kujdesit për fëmijët dhe objekte të tjera social kulturore, etj.

E drejta për veshmbathje vlerësohet më shumë se sa thjesht një domosdoshmëri fizike, pasi përfshin edhe elemente kulturore e fetare. Veshja është shpesh shprehje e kulturës, zakoneve, fesë, besimit ose opinionit politik të individit. Për shkak të ndryshimeve në nevojat dhe dëshirat e veshjeve, e drejta për veshje të përshtatshme është ndoshta më pak e përpunuar nga të gjithë komponentët që marrin pjesë apo përcaktojnë standardin e përshtatshëm të jetesës.

E drejta për ujë përfshin të drejtën për të patur akses në furnizimin me këtë element shumë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm të jetës. Çdo individ ka të drejtë të furnizohet me ujë në sasinë e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme për nevojat personale dhe të familjes së tij, si për ujin e pijshëm ashtu edhe ujin që duhet për nevojat e higjienës, larjes, etj. E drejta për ujë nënkupton të drejtën për t'u furnizuar me ujë cilësor sipas qëllimit të përdorimit të tij. E drejta për ujin shprehet në mundësinë që individi ka për të patur akses fizik apo edhe ekonomik, d.m.th., të ketë mjetet e duhura financiare për të paguar kostot e furnizimit me këtë element.

Të gjithë elementet e mësipërm, të cilët përfshijnë produkte ushqimore, jo ushqimore dhe me natyrë sociale, përbëjnë bazën për llogaritjen e minimumit jetik.

Në këtë pjesë të analizës financiare janë trajtuar dy aspekte të rëndësishme: (a) metodologjia që mund të përdoret për të përcaktuar nivelin e minimumit jetik, për shembull, bazuar në nevojat minimale të jetesës për të gjithë elementet bazë të një jete me dinjitet dhe (b) rruga që mund të ndiqet për të garantuar mbështetjen për të gjithë anëtarët e shoqërisë, të cilët ndodhen nën nivelin e varfërisë, të cilët nuk mund ta sigurojnë minimumin jetik përmes punës, kapitalit, apo nga burime të tjera, për shkak se resurset e tyre janë të kufizuara. Në këtë pjesë të analizës, në varësi të informacioneve disponibël, apo që mund të merren nga institucionet shtetërore, do të jepen sugjerime për të përlllogaritur, jo thjesht kontributin shtesë të shoqërisë, por edhe për të ndërtuar mekanizmat e nevojshme që do të harmonizonin më mirë aspektet pasive të akordimit të aksesit ekonomik me ato aktive apo të përpjekjeve që individët duhet të bëjnë për të gjetur burime përmes punës. Në këtë këndvështrim, për një grup individësh me pamundësi të përkohshme burimesh, aksesit ekonomik mund të kushtëzohet me përpjekjet që individi bën për të patur akses në tregun punës, siç mund të jetë pjesëmarrja në trajnime profesionale, në projekte vullnetare në dobi të komunitetit, të qenurit punëkërkues aktiv, etj.

Në nenin 5 të këtij projekt ligji është parashikuar që Këshilli i Ministrave përcakton metodologjinë dhe llogarit vlerën e minimumit jetik, që i duhet një individ, pa mjetet e nevojshme, për të plotësuar nevojat bazë të jetesës se tij si person ose familje (Neni 4), i cili indeksohet çdo vit.

Projektligji parashikon që minimumi jetik të barazohet me pensionin social të plotë. Në këtë mënyrë, indirekt përfitues do të jenë edhe individët/familjet në asistencë sociale, përfituesit nga skema e pensioneve, etj.

Nga kjo pikëpamje, zbatimi i këtij projektligji nuk paraqitet i vështirë, pasi ekziston një kuadër i plotë ligjor, nënligjor dhe rregullator për përcaktimin dhe zbatimin e kriterëve të kualifikimit për të gjithë kategoritë e përfituesve, përfshirë kushtëzimet e përfitimeve me statusin aktiv të punëkërkuarit, i cili adreson abuzimeve të mundshme për secilën nga skemat respektive.

Megjithatë, vështirësia kryesore lidhet me gjetjen e burimeve financiare shtesë për të furnizuar të gjithë skemat e pagesave për të përballuar rritjet përkatëse. Megjithëse përlllogaritja e efekteve financiare për të gjithë grupet që mund të preken, nuk është e lehtë, miratimi i projektligjit i vendos agjencitë qeveritare nën një presion pozitiv, veçanërisht në dy drejtimet e mëposhtme:

*(i) në përcaktimin e një metodologjie që mundëson llogaritjen e minimumit jetik më afër realitetit, dhe*

*(ii) në hartimin e buxheteve realiste dhe përcaktimin e instrumenteve praktike që ndihmojnë në zbatimin e minimumit jetik, fillimisht për individët nga shtresat më në nevojë dhe realisht nën kufirin e varfërisë, më pas për shtresat e tjera.*

Nuk ka dyshim që përlllogaritja e minimumit jetik dhe vlerësimi i nevojave për mjete financiare shtesë, e vendos qeverinë para vështirësive praktike për gjetjen e burimeve, përse kohë ekonomia jonë ende nuk e ka performancën e duhur për të prodhuar të ardhura buxhetore të mjaftueshme. Sidoqoftë, masa të tjera me natyrë politike, siç janë rritja e përvitshme e pagës minimale, do të bëjnë të mundur që, në kuadër të rritjes së punësimit, individët të mund të arrijnë nivelin e të ardhurave përtej minimumit jetik dhe të dalin mbi kufirin e varfërisë. Më poshtë disa llogaritje të përafërta për disa prej grupeve përfituese:

**(a) Përfituesit e pensionit social:** Masa e pensionit social të plotë (maksimal) është 8,102 leke, numri i individëve në pension social të plotë dhe të pjesshëm, është 2,337. Po të marrim parasysh llogaritjen e përafërt të minimumit jetik, sipas Avokatit të Popullit (në raportin e vitit 2021, bazuar në treguesit e vitit 2019) në shumën prej 17, 875 lekë në muaj, të rrumbullakosur në shumën 18,000 lekë në muaj, efekti maksimal vetëm për kategoritë e individëve në pension social të plotë do të ishte  $18,000 - 8,102 = 9,898$  lekë, ose një shtesë prej 222, 2%. Rritja sipas nenit 7, (shtojcës së projektligjit) do të jetë:

Periudha 2024-25–  $(0,65 \times 18000 - 8102) = 6434$  lekë ose një rritje në përqindje prej 144,4 %

Periudha 2026-2031 (0,85 x18000 – 8102) = 7198 lekë ose një rritje ne përqindje prej 188,84 %

Periudha 2032 e në vijim 9898 lek ose një rritje në përqindje prej 222, 2%.

Duke u nisur nga numri i individëve në pension social prej 2337 dhe pagesën e pensionit social në shumën vjetore gjithsej prej 180 milion lekë, (ku shuma mesatare e pensionit llogaritet në 6418.5 lekë) efektet financiare në vit sipas afateve të hyrjes në fuqi të projekt ligjit, për këtë kategori do te ishin:

	Shtesa e fondeve për pensionin social gjithsej	Ndihma Ekonomike Gjithësej	Pensioni i pleqërisë
Periudha 2024-25	+80 milion leke në vit	+1,700 milion lekë	Ka vështirësi për llogaritje të sakta
Periudha 2026-2031	160 milion leke në vit	+3,400 milion lekë	Ka vështirësi për llogaritje të sakta
Viti 2032 e në vijim	220 milion leke në vit	+4,679 milion lekë	Ka vështirësi për llogaritje te sakta

(b) **Përfituesit e ndihmës ekonomike/asistencës sociale:** Rritja e pensionit social deri në nivelin e minimumit jetik, ka ndikim në rritjen e masës së ndihmës ekonomike, pasi në zbatim të Ligjit 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 12.8. “... masa e ndihmës ekonomike, për familjet në nevojë, përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe shkon deri në 150 për qind të masës së pensionit social...”. Pra shumatat e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, duhet të rriten, dhe buxheti i shtetit do të duhet të shtojë fondin përkatës. Nga ndryshimi i pensionit social, pritet të ndryshojë baza për llogaritjen e ndihmës ekonomike.

Sipas INSTAT, gjatë vitit 2020, janë trajtuar me ndihmë ekonomike rreth 61,445 familje, të cilat kanë përfituruar shumën gjithsej prej 3,829,204,000 lekë në vit ose mesatarisht 5193.2 lekë për familje. Për të bërë llogaritjet nuk u morën në konsideratë të dhënat e vitit 2021, për faktin që ndihma ekonomike e këtij viti për një periudhe 6 mujore u dyfishua, për shkak të pandemisë.

Duke zbatuar të njëjtën logjikë që përdorëm për pensionin social, pagesa mesatare e ndihmës mujore për familje do të rritet sipas të tre periudhave të hyrjes në fuqi të projektligjit, më

respektivisht, 44.4%, 88.8% dhe 122.2%. Në këto kushte, burimet shtese për ndihmën ekonomike do të ishin:

Periudha 2024-25:  $5193,2 \text{ lekë} \times 6441 \text{ familje} \times 144,4 \% \times 12 \text{ muaj} = 5,529,298,504 \text{ lekë}$  ose + 1,700 milion lekë

Periudha 2026-2031:  $5193,2 \text{ lekë} \times 6441 \text{ familje} \times 188,8 \% \times 12 \text{ muaj} = 7,229,442,918 \text{ lekë}$  ose + 3,400 milion lekë

Viti 2032 e në vijim:  $5193,2 \text{ lekë} \times 6441 \text{ familje} \times 222,2 \% \times 12 \text{ muaj} = 8,508,380,383 \text{ lekë}$  ose + 4,679 milion lekë,

**(c) Përfituesit e pensioneve:** Sipas statistikave të INSTAT të vitit 2021, në skemën e pensioneve urbane ishin 566,423 individë, nga të cilat në pension pleqërie 460,214, pension invaliditeti 62,036 dhe pensione familjare 44,173; ndërsa në skemën e pensioneve rurale rezultuan të regjistruar 107,390 individë, prej të cilëve, në pensione pleqërie 96,803, pensione invaliditeti 6,143 dhe pensione familjare 4,444. Shuma e pagesave për skemën e detyrueshme për pensione për vitin 2021 ishte 126,126,000,000 lekë.

Nëse do të llogariten, të paktën individët që marrin pension minimal, prej rreth 160 mijë vetë, nga të cilat 124 mijë pensione urbane dhe 36 mijë pensione rurale, vlera e shtesës financiare për shkak të llogaritjes së minimumit jetik, do të rritej jashtëzakonisht shumë. Natyrisht, këto grupe kanë nevojë të vlerësohen dhe të klasifikohen më tej, sa u takon edhe burimeve të tjera shtesë që mund të kenë, siç mund të jetë kontributi i të punësuarve të tjerë të familjes ku ata jetojnë, pronësia në aktive (si toka, ndërtesa dhe aktive të tjera të investuara, etj.), me qëllim që si numri ashtu edhe shumën financiare shtesë, të mund të afrohen realitetit. Megjithatë, shifra e shtesës së përfitimeve, përsëri do të ishte shume e madhe.

Nëse nisemi nga supozimi hipotetik, se vetëm 30% e individëve që trajtohen me pension minimal, do të plotësonin kriteret për të patur përfitim financiar shtesë, pasi dukshëm do të ishin në mungesë të burimeve të tjera për jetesë, duke supozuar gjithashtu, se mesatarja e pensionit për këtë kategori është vetëm 12,000 leke, shumën shtesë për të u përballuar nga buxheti i shtetit në fazën e tretë të zbatimit të minimumit jetik do të llogaritej:

$160,000 \times 0,3 \times (18,000 - 12,000) \times 12 \text{ muaj} = 3,456 \text{ milion lekë.}$

Por kjo shifër nuk është e saktë pasi as numri i përfituesve, as masa e pensionit mesatar, por edhe as masa e supozuar e minimumit jetik nuk mund të konsiderohen të përlllogaritura me saktësinë e kërkuar. Sidoqoftë, mënyra e llogaritjes ndihmon të kuptohet prirja, dhe evidenton kompleksitetin që ka zgjidhja gjithëpërfshirëse dhe e menjëhershme e çështjes së minimumit jetik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Lënda: Njoftim vendimi

Data  
4.10.2022

DREJTUAR: **Zj. Anxhela NASTO**

**Z. Arlind QORI**

**Z. Jani MARKA**

**Zj. Mirela RUKO**

**Zj. Geraldina MANÇKA**

**Z. Redi MUÇI**

**Zj. Vitori ÇIPI**

**Z. Xhuliano BREGASI**

Nr. Protokolli  
3322

Adresa: Rruga "Abdullah Keta", nr. 1, Tiranë

Të nderuar,

Ju bëjmë me dije se, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 198, datë 29.09.2022 "Për shqyrtimin e kërkesës së Komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve, për propozimin e projektligjit "Për përcaktimin e minimumit jetik", vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve dhe publikimin e saj në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimin mund ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al), në rubrikën <Akte>, <Akte të Komisionerit>. Bashkëlidhur ju dërgojmë kopjen e vendimit të zbardhur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

**YIL MERKAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9.1.2023

Nr: 5

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMITETIT PËRFAQËSUES TË NISMËS LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE, PËR REGJISTRIMIN E NISMËS LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE "PËR PËRCAKTIMIN E MINIMUMIT JETIK"**

Në mbështetje të neneve 19, pika 2 dhe 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 14, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidateve dhe miratimin e modeleve të kandidimit", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse të zgjedhësve, i përbërë nga 8 (tetë) zgjedhës si vijon: zj. Anxhela Nasto, z. Arlind Qori, z. Jani Marka, zj. Mirela Ruko, zj. Geraldina Mançka, z. Redi Muçi, zj. Vitori Çipi dhe z. Xhuliano Bregasi, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 3197 prot, datë 16.09.2022, për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit "Për përcaktimin e minimumit jetik".

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 198, datë 29.09.2022, vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit "Për përcaktimin e minimumit jetik". Vendimi përcaktoi afatin 3 (tre) mujor nga hyrja në fuqi e tij, për mbledhjen e nënshkrimeve.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa me nr. 3978 prot., datë 9.12.2022, me lëndë "Depozitimi i nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve, për propozimin e projektligjit "Për përcaktimin e minimumit jetik". Bashkëlidhur kërkesës është

Data: 9.1.2023 Nr: 5  
Ora: 11:30



"Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve "për përcaktimin e minimumit jetik"

depozituar edhe Memorandumi i Bashkëpunimit midis Komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse dhe grupit të mbledhjes së nënshkrimeve, si edhe një shkresë shoqëruese e të gjitha nënshkrimeve të cilat janë identifikuar paraprakisht si të pavlefshme.

Referuar nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, me depozitimin e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nënshkrimet si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor për verifikimin e nënshkrimeve dhe në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi i tyre, dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:


- a) regjistron nismën ligjvënëse të zgjedhësve;
- b) cakton një afat kohor për plotësimin ose korigjimin e pasaktësive të nënshkrimeve;
- c) refuzon regjistrimin e nismës nëse nga verifikimi rezulton se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën, duke depozituar identitetin dhe firmat e tyre, është më i vogël se 20 000 zgjedhës.

Në referim të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri ftoi përfaqësuesit e komitetit nismëtar, për të qenë prezent në seancën publike për verifikimin e numrit të nënshkrimeve.

Në mbështetje të sa më sipër cituar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e 5 (pesë) për qind të numrit të nënshkrimeve si dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, brenda afatit ligjor të parashikuar.

Në total janë depozituar 932 fletë, me 21 300 nënshkrime, të ndara në 6 dosje. Në referim të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet që nisma ligjvënëse të nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 zgjedhës. Ka rezultuar se numri i zgjedhësve të cilët kanë mbështetur nismën e plotëson numrin prej 20 000 zgjedhësish të kërkuar nga ligji.

Përsa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nënshkrimet e depozituara nga përfaqësuesit e nismës ligjvënëse për të propozuar projektligjin “Për përcaktimin e minimumit jetik”, janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe si të tilla duhet të pranohen.



## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 2 dhe 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 14, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

## VENDOS:

1. Regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për përcaktimin e minimumit jetik”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

